



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

PA1 Nr.08-209

10.10.2023

Shkup

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 2, neni 20, paragrafi (1), nënparagrafi 10¹, dhe në lidhje me nenin 76, paragrafi (7), dhe nenin 24 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20, 77/21 dhe 154/23), neni 15, paragrafi (1), nënparagrafi 2, neni 39, paragrafi (1), nënparagrafi 10 dhe neni 51, paragrafi (3) të Rregullores së punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019 dhe nenin 9 të Rregullores për zonat e transmetimit të shërbimeve programore televizive dhe në radio, ark.nr.01-5778/1 datë 21.11.2014 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.172/14, në lidhje me kërkesën e dorëzuar për dhënie të lejes pa shpallje të konkursit publik për transmetim televiziv (PA1 nr.08-209 datë 06.06.2023, plotësuar me datë 26.07.2023 dhe me datë 07.09.2023), nga personi juridik Shoqëria Tregtare Radiodifuzive KTV SHPKNJP Kavadar dhe Konkluzioni ark.nr.02-3637/2 të datës 09.10.2023, në seancën e 32-të mbajtur më 09.10.2023, miratoi si vijon:

VENDIM

për dhënie të lejes për transmetim televiziv nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon burim të kufizuar në nivel rajonal

1. I NDAHET leja për transmetim televiziv shërbimit programor me format të përgjithshëm kryesisht argëtues, në gjuhën maqedonase, në nivel rajonal, zona e shpërndarjes D1 Crn Vrv - zonë në nivel rajonal Veles (komunat Veles, Çashkë, Sveti Nikollë, Lozovo, Gradsko, Rosoman, Negotinë dhe pjesë e komunës së Kavadarit), personit juridik Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KTV SHPKNJP Kavadar², me NVAS 4242122.

Shërbimi programor televiziv nga paragrafi (1) i kësaj pike do të transmetohet nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon burim të kufizuar.

2. Leja nga pika 1. e këtij Vendimi, ndahet për periudhë kohore prej 9 (nëntë) vjetësh.

3. Pas pranimit të këtij Vendimi, kërkuesi për dhënien e lejes, personi juridik Shoqëria Tregtare Radiodifuzive KTV SHPKNJP Kavadar, të cilit i është dhënë leja nga pika 1. e këtij Vendimi, duhet të kryej ndryshim të regjistrimit në regjistrin përkatës, duke qenë se tashmë është i regjistruar si Shoqëri Tregtare Radiodifuzive në regjistrin përkatës pra në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV-së), në bazë të Vendimit të Këshillit të Agjencisë për zëvendësim të lejeve ekzistuese për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive me leje të reja për transmetim televiziv ose radio, PA1 nr.08-713, datë 27.12.2014.

4. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive KTV SHPKNJP Kavadar, të cilës i është dhënë leje nga pika 1. e këtij Vendimi, do të paguajë kompensim vjetore në llogarinë e Agjencisë, për çdo vit aktual duke filluar nga data e dhënies së lejes në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia.

¹Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: Nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 248/18).

²SHTR KTV SHPKNJP Kavadar është radio transmetues ekzistues, zotëruar i lejes për transmetim televiziv në nivel rajonal, me zonë për transmetim D1-Crn Vrv/Veles nëpërmjet multipleksit tokësor digjital, Nr ynë PA11 nr. 08-19 datë 05.01.2015, vazhduar me Vendim, Nr ynë PA1 nr. 08-258, datë 15.08.2023.

5. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive KTV SHPKNJP Kavadar, të cilës i është dhënë leje nga pika 1. e këtij Vendimi, obligohet që menjëherë të fillojë me ushtrimin e veprimtarisë pas dhënies së lejes për transmetimin televiziv nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon burim të kufizuar në nivel rajonal.

Në rast të mosrespektimit të afatit për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë cekur në paragrafin (1) të kësaj pike të Vendimit, Agjencia do të marrë lejen e dhënë para skadimit të afatit për të cilën është dhënë dhe do ta fshijë transmetuesin nga regjistri i radiodifuzerëve.

6. Ky Vendim është përfundimtar dhe do të publikohet në ueb faqen e Agjencisë.

A r s y e t i m

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) në pajtim me nenin 76 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), ndanë leje për transmetim televiziv ose radio nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon burim të kufizuar ose nëpërmjet satelitit, për të cilin nuk shpallet(hapet) konkurs publik dhe leja i ndahet me kërkesë të palës së interesuar në mënyrë dhe procedurë të përcaktuar me Ligjin e cituar.

Drejtuar Agjencisë, më 06.06.2023 është dorëzuar Kërkesë për dhënie të lejes pa shpallje (hapje) të konkursit publik Nr ynë PA1 nr.08-209, për transmetim televiziv të shërbimit programor kryesisht me format të përgjithshëm argëtues, në gjuhën maqedonase, në nivel rajonal D1 Crn Vrv/Veles, i cili do të transmetohet nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik dhe që nuk shfrytëzon burim të kufizuar, parashtruar nga ana e personit juridik Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) KTV SHPKNJP Kavadar dhe nga personi fizik Angel Danov (drejtues dhe themelues /pronar i SHTR KTV SHPKNJP Kavadar.)

SHTR KTV SHPKNJP Kavadar është zotëruar i lejes për transmetim televiziv në nivel rajonal, me zonë për transmetim D1-Crn Vrv/Veles nëpërmjet multipleksit digjital tokësor, Nr ynë PA1 nr.08-19 datë 05.01.2015, vazhduar me Vendim, Nr ynë PA1 nr. 08-258, datë 15.08.2023. Ndaj Kërkesës për dhënie të lejes pa shpallje të konkursit publik për transmetim televiziv (PA1 nr.08-209 datë 06.06.2023, 6.06.2023, plotësuar më 26.07.2023 dhe më 07.09.2023) nga ana e themeluesit/pronarit të SHTR KTV SHPKNJP Kavadar me datë 04.10.2023, është dorëzuar Deklaratë, Nr ynë PA1 nr.08-258 e noterizuar, DHP nr.4326/2023 e datës 04.10.2023, se pajtohet me dhënien e lejes për transmetim televiziv nëpërmjet operatorit të rrjetit publik të komunikimit elektronik, ku pushon së vlefshmi leja ekzistuese për transmetim televiziv në nivel rajonal, me zonë për transmetim D1-Crn Vrv/Veles nëpërmjet multipleksit digjital tokësor, Nr ynë PA1 nr.08-19 datë 05.01.2015, vazhduar me Vendim, Nr ynë PA1 nr.08-258, datë 15.08.2023.

Pas pranimit të Kërkesës për dhënie të lejes pa shpallur(hapur) konkurs publik për transmetim televiziv, PA1 nr.08-209, datë 06.06.2023, Shërbimi Profesional i Agjencisë vazhdoi shqyrtimin e njëjtë dhe konstatoi se kërkesa e paraqitur nuk ishte plotësuar siç duhet dhe përmban disa mangësi, gjegjësisht se është e paplotë. Për sa më sipër, Agjencia, në pajtim me nenin 76, paragrafi (6) të LSHMAAV, me datë 05.07.2023, me shkresë-Njoftim, PA1 nr.08-209, datë 07.05.2023, ka njoftuar kërkuesin për dhënien e lejes - personin juridik SHTR KTV SHPKNJP Kavadar dhe e obligoi që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Njoftimit, që të plotësojë kërkesën në fjalë dhe t'i mënjanojë mangësitë e konstatuara. Kërkuesi për dhënien e lejes, në afatin e caktuar nga Agjencia, pra më 26.07.2023, ka paraqitur Plotësim të Kërkesës (Nr ynë PA1 nr.08-209, datë 26.07.2023) me të cilën ka plotësuar Kërkesën për dhënien e lejes pa shpallur(hapur) konkurs publik për transmetim televiziv (PA1 nr.08-209, datë 06.06.2023). Pas shqyrtimit të kërkesës së plotësuar, Shërbimi Profesional i Agjencisë ka konstatuar se sërish ka disa mangësi që duhen hequr(mënjanuar), në lidhje me të cilën kërkuesi për dhënien e lejes i është dërguar Shkresë-njoftim Nr ynë PA1 nr.08-209 datë 21.08.2023, të heqë mangësitë dhe sërish obligohet që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Njoftimit, të plotësojë Kërkesën për dhënien e lejes pa shpallur(hapur) konkurs publik (PA1 nr.08-209 datë 06.06.2023, me plotësim nga data 26.07.2023). Me datën 07.09.2023, kërkuesi për dhënie të lejes, personi juridik SHTR KTV SHPKNJP Kavadar, ka dorëzuar plotësim të dytë të Kërkesës ose Kërkesë të dytë plotësuese PA1 nr.08-209, për dhënien e lejes pa shpallje të konkursit publik për transmetim televiziv. Pas shqyrtimit të kërkesës, u konstatua se e njëjta është e rregullt dhe e plotë.

Agjencia, me qëllim për vërtetim të drejtë të fakteve për miratimin e vendimit për dhënie të lejes për transmetim televiziv, gjegjësisht për tu përcaktuar se në cilat Shoqëri Tregtare paraqitet si themelues/pronar personi juridik SHTR KTV SHPKNJP Kavadar, si dhe themeluesi i këtij personi juridik Angel Danov, i cili njëkohësisht është edhe drejtues, më 26.09.2023 nëpërmjet Sistemit të shpërndarjes së internetit të Regjistrisë Qendror të RMV-së ka ofruar (siguroi) "Informacion për subjektet e ndërlidhura (personat e autorizuar, organet drejtuese, pronarë në subjekte të tjera) – gjendja vijuese" për SHTR KTV SHPKNJP Kavadar dhe për personin fizik Angel Danov, dhe nga Regjistri i Pronarëve të Vërtetë ofroi edhe "Gjendjen vijuese për personin fizik - pronar i vërtetë" (Nr ynë nr.08-209, datë 28.09.2023), nga ku shihet se në cilat subjekte ky person paraqitet si pronar i vetëm, nga ku u konstatua se nuk janë shkelur dispozitat e Kreut IV të LSHMAAV.

Pas shqyrtimit të Kërkesës së paraqitur për dhënie të lejes pa shpallur(hapur) konkurs publik për transmetim televiziv, në nivel rajonal (Nr ynë PA1 nr.08-209, datë 06.06.2023, me plotësim nga

26.07.2023 dhe nga 09.07.2023), dhe në pajtim me nenin 76, paragrafi (7) të LSHMAAV, është përcaktuar se kërkesa në fjalë është e rregullt dhe e plotë, se kërkuesi në fjalë i plotëson kushtet dhe detyrimet e përcaktuara me LSHMAAV dhe Rregulloreve të miratuara në bazë të këtij Ligji, si dhe faktin që kërkuesi, personit juridik SHTR KTV SHPKNJP Kavadar, nuk i është hequr leja për transmetim televiziv në 5 (pesë) vitet e fundit.

Në pajtim me nenin 76, paragrafi (7) të LSHMAAV, Agjencia do të marrë vendim për dhënien e lejes brenda tre muajve nga dita e pranimit të kërkesës së rregullt, nëse përcakton se kërkuesi i përmbush kushtet dhe detyrimet e përcaktuara me këtë ligj dhe rregulloret e miratuara në bazë të Ligjit dhe nëse kërkuesi nuk i është hequr leja për transmetim televiziv ose radio.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, Drejtori i Agjencisë, Dr. Zoran Trajčevski, drejtuar Këshillit të Agjencisë i dorëzoi Propozim PA1 nr.08-209 datë 05.10.2023, për miratim të Vendimit për dhënien e lejes për transmetim televiziv nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon burim të kufizuara, në nivel rajonal.

Pas pranimit të Vendimit për dhënien e lejes, personi juridik SHTR KTV SHPKNJP Kavadar, të cilit i është dhënë leja nga pika 1 e këtij vendimi, duhet të kryej ndryshim në regjistrin përkatës, duke qenë se tashmë është regjistruar si Shoqër Tregtare Radiodifuzive në regjistrin përkatës në Regjistrin Qendror të RMV-së, në bazë të Vendimit të Këshillit të Agjencisë për zëvendësimin e lejeve ekzistuese për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive me leje të reja për transmetim televiziv ose radio, PA1 nr.08-713, datë 27.12.2014 SHTR KTV SHPKNJP Kavadar, të cilës i është dhënë leja nga pika 1. e këtij Vendimi, do të paguajë kompensim vjetor në llogarinë e Agjencisë, për çdo vit aktual duke filluar nga data e dhënies së lejes në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia. Mënyra e llogaritjes, faturimit dhe arkëtimit të kompensimit të lejes për transmetim televiziv sipas kërkesës nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon burim të kufizuar, përcaktohet nga Agjencia në pajtim me nenin 80 nga Ligji i cituar dhe në pajtim me Rregulloren për procedurat e punës financiare dhe kontabël të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, ark.nr.01-6222/1 datë 12.12.2014 SHTR KTV SHPKNJP Kavadar, të cilës i është dhënë leja nga pika 1. e këtij Vendimi, detyrohet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë menjëherë pas dhënies së lejes për transmetimin televiziv nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon burim të kufizuar në nivel rajonal dhe nëse zotëruesi i lejes nuk fillon të kryejë veprimtarinë brenda afatit të përcaktuar në leje, Agjencia në pajtim me nenin 82, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, do të heqë lejen e dhënë para skadimit të afatit për të cilin është dhënë dhe do ta fshijë transmetuesin nga regjistri i radiodifuzerëve .

Bazuar nga sa më sipër, Këshilli i Agjencisë në seancën e 32-të mbajtur më 09.10.2023, dhe në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-3637/2 datë 09.10.2023, miratoi Vendim si në dispozitiv, i cili është përfundimtar dhe pas miratimit të tij do të publikohet në ueb faqen e Agjencisë

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, Kërkuesi për dhënien e lejes për transmetim televiziv nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik, nëse është i pakënaqur me vendimin, ka të drejtë padie para gjykatës kompetente, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.